

Frutikulture: Fishe teknike: Menaxhimi i plehimit pemeve frutore

N° 04

Adad Malore:
info@adadmalore.al
www.adadmalore.al

Specialist

Mehmet PUPA,
Tel: +355682180985

Dr. Hafuz DOMI

Tel: +355682066485,
domihafuz@yahoo.com

Plehërimi shërben për të mbështetur rendimentin e pemëtores, për të arritur cilësinë e kërkuar të frutave nga tregu dhe për të zëvendësuar elementët ushqyes të larguar, me qëllim që të mos varfërohet toka.

Për një strategji korrekte të të ushqyerit të mollës duhet të merren në konsideratë: Përmbajtja e lëndëve ushqyese të tokës dhe vetitë e tokës

- Nxjerrja e elementëve ushqyese nga kultura
- Funkcionet e elementëve ushqyese, periudha e absorbimit maksimal dhe lëvizja e lëndëve ushqyese në tokë dhe në bimë
- Vetitë e plehrave për t'i përdorur ato me eficiensë dhe në mënyrë më korrekte.

Kur duhen perdoren plehrat ne pemetore?

Kur duhet përdorur		Përqindja e përdorimit	
		Azoti (N)	Potasi (K)
2 javë pas çeljes së sytheve		30 - 40% e totalit	40% e totalit
Lidhje e frutave (Lulëzim/rënie e petlave)		30 e totalit	30 e totalit
1 javë pas vjeljes		30 - 40% e totalit	30 e totalit


Elementët ushqyes të kërkuar

- Makroelementet: N, P, K, Ca, Mg, S
- Mikroelementet: B, Zn, Cu, Mn, Fe, Mo

Kur duhet të përdor elementet ushqyes në mollët time?



Kur duhet të përdor elementet ushqyes në mollët time?

							
Hapja e sythave	Gjethe veshmitu	Gonxhe e kuqe (Gonxhe e bardhe)	Rënie e petjave	Lidhje e frutave	Rritje e frutave	Fillimi i pjekjes	Pas vjeljes
30% e totalit N				30% e totalit N			40% e totalit N
40% e totalit K				30% e totalit K			30% e totalit K

Plane alternative plehërimi për rendiment 400 kv/ha mollë për pemëtore në toka me pjellori mesatare

Plehërim mineral me plehra të thjeshtë:		
Në vjeshtë	Nitrat amoni 26% N -----	180 kg/ha
	Superfosfat -----	300 kg/ha
	Sulfat potasi -----	280 kg/ha
Në pranverë	Nitrat amoni 26% N -----	280 -360 kg/ha
Plehërim mineral me plehra të përbërë:		
Në vjeshtë	Pleh i përbërë 12-12-17 -----	500 kg/ha
	Sulfat potasi -----	110 kg/ha
Në pranverë	Nitrat amoni 26% N -----	230 -300 kg/ha
Plehërim mineral me fosfat biamoni (DAP):		
Në vjeshtë	Fosfat biamoni (DAP) 18- 46 ----	130 kg/ha
	Sulfat potasi -----	280 kg/ha
	Nitrat amoni 26% N -----	90 kg/ha
Në pranverë	Nitrat amoni 26% N -----	280 -360 kg/ha

Plehërimi i mollës ka tre objektiva kryesore:

- Përgatitja e bimës për prodhim
- Mbështetje për formimin dhe zhvillimin e frutave
- Përgatitja për vjeljen pasardhëse përmes akumulimit të lëndëve ushqyese rezervë në pemë

Këto objektiva mund të arrihen përmes elementëve të ndryshëm ushqyes që duhet të hidhen me plehra.

Shembull: Për një prodhim prej 600 kv/ha mollë (kundrejt 400 kv/ha rendimenti referuese) faktori korrektues do të jetë 1.33 ($600 / 2 \times 400 + 0.5 = 1.25$)

Azot: $120 \times 1.25 = 150 \text{ kg N/ha}$

Fosfor: $60 \times 1.25 = 75 \text{ kg P}_2\text{O}_5/\text{ha}$

Potas: $140 \times 1.25 = 175 \text{ kg K}_2\text{O/ha}$